



KUVENDI I KOMUNËS-SUHAREKË
SKUPŠTINA OPŠTINE - SUVA REKA
MUNICIPALITY OF SUHAREKA



PROCESVERBAL VIII/2021

**I mbajtur me rastin e mbledhjes së 8 (tetë) të rregullt për vitin 2021 të Kuvendit të
Komunës së Suharekës**

Vendi: Suharekë
Zyra: Salla e Kuvendit të Komunës
Data: 27.08.2021
Ora: 10.00

Prezentë në takim:

Z. Nexhat Ramadani
Z. Bashkim Ndrecaj
Z. Brahim Curri
Z. Alban Berisha
Z. Shefket Kolgeci
Z. Xhemajl Kabashaj
Znj. Elmaze Bytyqi
Znj. Bulëza Kuçi
Znj. Shqipe Ramaj
Z. Lirim Qatani
Z. Reshat Selimaj
Z. Ardian Kotorri
Z. Bexhet Kuçi
Z. Aziz Bytyqi
Z. Gazmend Gashi
Znj. Bardha Gashi
Znj. Mirlinda Muqa

Z. Rilind Krasniqi
Z. Jeton Rrakaqi
Z. Arbërim Basha
Z. Dardan Berisha
Znj. Marigona Gashi
Znj. Florie Bytyçi
Z. Sami Hajdari
Znj. Shkëndije Zenelaj
Z. Osman Selimaj
Z. Leonard Shala
Z. Dugagjin Palushi
Znj. Laureta Tafaj
Z. Gëzim Kryeziu
Znj. Afërdita Morina

Të pranishëm të tjerë

Kryetari Komunës

Media dhe qytetarë
OSCE, LMT, KDI
Znj. Habibe Bytyqi
Z. Xheladin Sadikaj

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Kryesuesi i Asamblesë Komunale z.Bexhet Kuçi dhe e prezantoi rendin e ditës:

REND DITE

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Shqyrtimi projekt-vendimit për shfuqizimin e vendimit;**
- 3. Shqyrtimi i planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të ZKA;**
- 4. Shqyrtimi i raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Suharekës për vitin 2020;**
- 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për ndërprerjen e subvencioneve të qytetarëve të Komunës së Suharekës të infektuar me Covid-19;**
- 6. Pyetje dhe përgjigje;**

Kryesuesi - përshëndet të pranishmit dhe e hedh në votim rendin e ditës.

Unanimisht Miratohet

Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi - a keni ndonjë vërejtje në procesverbal?

Dugagjin Palushi - është i shkurtum, nuk lidhen tema me temë. Ka disa gjana që thuhet e nuk qiten,e disa që nuk thuhet e qiten.

Kryesuesi - e hedh në votim.

Miratohet

Pika 2. Shqyrtimi projekt-vendimit për shfuqizimin e vendimit;

Kryesuesi - elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Dugagjin Palushi - ky vendim është vazhde e vendimeve tjera që kanë ardhë në mënyrë flagrante. Ju është dashtë me sqarua atje e pastaj me pru në Asamble. Na keni pru para akteve të kryne. Në mënyrë publike kërkoni falje e shohim pastaj.

Jeton Rrakaqi - përshëndet të pranishmit. Nuk është hera e pare që po bini kësi vendime. Para se me pru këtë kërkesë është dashtë mu konsulto me ministrinë, edhe me përfaqësuesin ligjor,e jo me ardh kështu e gatshme. Grupi parlamentar i PDK-së voton kundër.

Shqipe Rama - përshëndet të pranishmit edhe unë jam kundër këtij shfuqizimi. Përderisa është votu unanimisht besoj që duhet me bo përpjekje për me shti n'funksion.

Kryetari - përshëndet të pranishmit.Kërkesa nga sindikata ka qenë që të fillohet prej janarit të vitit 2022,dhe ka pas përfaqësues të partive politike që kanë kërku që të fillohet këtë vit.Ne e kem bo kërkesën,mirëpo ligjshmëri nuk ka dhe për këtë është kthyer.

Kryesuesi - kur ka ardh në rend dite,unë e kam bo elaborimin në bazë të kërkesës që të filloj në janar të vitit 2022, por kërkesa ka dal nga Asamblea që të bëhet prej 1 korrikut të këtij viti.

Jeton Rrakaqi - nëse ka qenë ashtu atëherë edhe ju është dasht me votu kundër Kryesues. Para se me hedh në votim,përfaqësuesi ligjor është dasht me thane që është jo legjitime dhe votone sipas kërkesës.

Avni Bytyqi - unë e kam dhënë sqarimin ligjor edhe në mbledhjen e kaluar ku është miratuar ky vendim dhe në aspektin ligjor ky vendim ka qenë në rregull, por Ministria e Financave nuk e ka kthye që është në kundërshtim me ligjin por për shkak që nuk ka buxhet të planifikuar për vitin 2021 dhe çështja e planifikimit të buxhetit nuk është çështje e imja po kjo është çështje e drejtorit të buxhetit.

Nexhat Ramadani - thanë edhe para folësit Dugagjini dhe Jetoni që jemi msu që pjesën dërmuese na kanë ardh projekt-vendime gjithmonë. Në KPF kamë thënë që do ta propozojmë prej 1 korrikut,për faktin se, për 2022 nuk keni pas nevojë me pru pesë muaj përpara. Ju si ekzekutiv është dasht me marrë kërkesën dhe me i than sindikatës ,që ne zotohemi që do ta fusim në planifikim për vitin 2022. Ju nuk keni guxim mi bind që në fakt nuk ka qenë e zorshme pasi kërkesa ka qenë për vitin 2022,por ju e keni logjikën me qu në Kuvend dhe me thane që ai ose ajo se votoj. Cilat janë përpjekjet e juaja serioze për me zbatu vendimin që është marrë në mënyrë unanime?Nuk keni bo asnjë përpjekje. Ne si grup parlamentar i LDK-së nuk do ta shfuqizojmë këtë projekt-vendim. Eksitojnë mundësitë që nëse bëhet pak përpjekje me gjet zgjidhje për këtë çështje.

Ardian Kotorri - përshëndet të pranishmit të gjithë e dimë që vendimi ka qenë prej një janarit të vitit 2022 me hy në fuqi,por me vullnetin tone e kemi bo prej korrikut. Ska kurgja të keqe për gjithë këto fjalë. S'ka pas mundësi ligjshmërie prej korrikut, atëherë pse mos ta shfuqizojmë dhe ta lëmë prej vitit 2022.

Nexhat Ramadani - unë mendoj që nuk kemi fol shumë por kemi thënë atë çka duhet. Shqetësimi jonë është që, pse ju na shtini me marrë vendime ,të cilat ju e dini që s'bëhen.

Pra vërejtja është që ju s'keni bo kurgja për me realizuar ni vendim të Asamblesë që është votu unanimisht.

Kryesuesi - e hedh në votim.

**11 për, 14 kundër, 1 apstenim
nuk Miratohet Pika 2.**

Pika 3. Shqyrtimi i planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të ZKA;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin. Nuk ka debat.

Pika 4. Shqyrtimi i raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Suharekës për vitin 2020;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Nexhat Ramadani - ne kemi pas ni debat të organizuam nga kallxo.com lidhur në raportin e auditorit. Në debat kam ngrit disa çështje që i kam ngrit edhe ma herët .Mendoj që çdo here jam mundu me ngrit ato që qëndrojnë dhe që janë në interes të funksionimit ma të mire të Institucionit. Ka disa gjetje të cilat nuk janë për t'mos u shqetësuar, sidomos çështja e subvencioneve dhe transfereve. Ka dhënë tri vërejtje që janë të rëndësishme dhe thelbësore. 1. nuk e ka bo planin vjetor të ndarjes së subvencioneve,që është obligim ligjor; 2 .nuk ka bo komision i cili e mbykqyr procesin e shpërndarjes ,dhe 3. nuk ka bo komision të ankesave. Ka pas edhe vërejtje te investimet kapitale. Shqetësimi tjetër është gjetjet te pagesat,te situacionet,të cilat nuk

janë kry. Dyshoj që ka edhe shumë defekte të tjera brenda kontratës. Unë në një far forme e kontestoj një raport të tillë, sepse mendoj që nuk paraqet gjendjen reale, por nuk i kontestoj mostrat që i kanë marrë ata. Te investimet kapitale kanë marrë 70 mostra për teste substanciale, ndërsa te këto që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë kanë marrë 5 mostra, dhe shqetësimi jonë është te kjo, sepse investimet kapitale nuk kanë shku në pajtueshmëri me ligjet në fuqi, konkretisht me ligjin për menaxhimin e financave publike nenin 17. Unë si delegate kam dhënë një kontribut të qmueshëm sa i përket hartimit të buxhetit dhe për shumë çështje tjera por kur kam fillu mi analizu kontratat kam pare cila është gjendja atje, dhe kemi dhënë vërejtje këtu. Kur e kam bo analizën në 2020 kam pa që kjo është dukuri. Jam mundu në mënyrë të sigurtë konform përgjegjësive dhe detyrave që i kam mi paraqit këtu para delegatëve ato argument të cilat i kam pas bindëse. Mendoj që shumica e dine. Ju si Kryetar mbani një përgjegjësi shumë të madhe, keni shkel ligjin. Unë nuk do ta bëj çështjen te prokuroria por ka me bo çmos me bo publike që Kryetari shkel ligjet, abuzon me buxhetin që e mbledhim prej qytetarëve dhe nuk e shpërndan ashtu siq është me ligj.

Kryetari - faleminderit për kritikën. Ke qenë drejtor i shërbimeve publike dhe merre kqyre raportin e shërbimeve publike në 2017, sa rekomandime janë kanë. Gjashtë rekomandime i kemi, tre me vetëdije i kemi bo, njëra për paga për punëtorët e karitasit, e dyta për komunalit dhe tre, kemi një zyrtar të USAID i cili vazhdimisht përcjell punimet. Unë jam mundu me kry punën time me nder, por në qoftëse fillon me kundërshtu zyrën e auditorit, nuk i beson, ata i kanë masat e veta. Në 2017 opinioni i kalfifikuar me theksim të qështjes.

Është një ndër Komunitat që auditori ka dal ma së miri.

Kryesuesi - zyra kombëtare e auditorit i raporton vetëm parlamentit të Kosovës dhe e bën raportin sipas të gjeturave të punës.

Nexhat Ramadani - unë qartë e thashë që unë nuk i kontestoj mostrat që i kanë marrë ata, por kam të drejt me dyshu dhe është normale. Sa i përket qështjes së 2017, theksimi i qështjes ka qenë te keq klasifikimet e mjeteve nëse nuk kam harrru. Lexon opinionin e auditimit për vitin 2020 te Theksimi i qështjes, pastaj lexon dhe arsyetimin. Pra kjo është qështje që ka qenë edhe ma herët e që është modifikuar por auditori tani ka vendos mos me theksu qështjen për faktin se është dukuri në krejt institucionet. Kjo qështje është dasht me u theksu.

Jeton Rrakaqi - edhe unë kam shpreh dyshime edhe te ta. I cek Nexhati që nuk janë cekë shumë qështje. Te gjeturat te ura, kam kërku sqarime dhe nuk ke dhënë. Auditori ka shpreh pakënaqësi për marrëveshjet e brendshme përmes operatorëve ekonomikë, ku çmimi më i vogël iu ka besu operatorit të dytë me çmim më të lartë te tenderi për ndriçimin publik. Po ashtu edhe tenderët e shërbimeve publike ku janë pranuar si punë të përfunduara punimet që nuk janë realizuar në praktikë. Kërkoj përgjigje nga Kryetari.

Xhemajl Kabashi – nëse raporti i viti 2017 nuk ka qenë në rregull, nuk do të thotë që edhe 2021-ta të mos jetë në rregull. Vërejtja që është dhënë te rasti i projektit te urave Leshan-Reshtan-Studenqan-Suharekë te Mulliri Beqës, dhe ku është bo ekzekutimi, pa u kry punët përfundimtare sidomos Suharekë te Mulliri Beqës thotë ekzekutohen gjitha pagesat, ndërsa raporti auditorit thotë se në këtë urë nuk vendosen parmakët dhe situacioni 5-të paguhet dhe Komuna dëmtohet në vlerë 5 mijë euro. A është i mire ky raport? A keni marrë naj masë?

Alban Berisha - subvencionimi i OJQ-ve - te gjetja e dytë, çfarë mekanizmi u përdor për mi monitoru këto projekte që janë subvencionu apo vetëm janë mbyll me një raport dhe me faktura të restoranteve dhe hoteleve këto projekte?

Kryetari - është një komision që ka vendos për ndarjen e subvencioneve. Të gjithë ata që kanë kërku subvencione, të gjithë kanë marrë, pa dallim, por mund të kërkon edhe raport te drejtori i Kultures.

Alban Berisha - nuk të akuzova për ndarje të padrejtë,Pyetja ishte si janë mbyllë dhe jo si i ke dhënë.

Pika 5. Shqyrtimi i projket-vendimit për ndërprerjen e subvencioneve të qytetarëve të Komunës së Suharekës të infektuar me Covid-19;

Kryesuesi - elaboron këtë pike dhe hap debatin.

Kryetari - vitin e kaluar kemi marrë vendim me i subvencionu të gjithë ata që janë të prekur me Covod 19,pra të gjithë ata që vin nga instituti dhe jo privat. Kemi numër shumë të madhë deri 500-600 raste për tre katër ditë.Unë kam propozu me shfuqizu këtë vendim prej 1 gushtit,por prap ju vendosni si të doni.

Besa Kuçi - përshëndet të pranishmit gjatë muajit gusht kemi 858 raste të reja,total kemi 2449 raste .Aktive janë 790 raste ,82 vdekje.30 pacient janë të hospitalizuar në spitalin e Prizrenit 6 infermier dhe dy doktor janë të infektuar. Të vaksinuar janë 8275. Aplikacionet për subvencionim: total janë 849 aplikacione,ku në proces për pagesë janë 844 persona. Në konsullt me ZKF-në i kem gjet edhe 60 mijë euro. Për ma tutje i bie ti gjejmë edhe 151,500.00 eoro për rastet e pjesës tjetër. Mendimi ynë është që ky vendim të ndërprehet për shkak se ka dal vaksina dhe njerzit mund të imunizohen. Ose këto mjete me shku për barna ose terapi antikovid.

Florije Bytyqi - përshëndet të pranishmit. Kjo iniciativë ka qenë e PDK-së,prej 50 euro,dhe ju keni marrë vendim që të infektuarve tu ndahen 100 euro dhe për të vdekurit tu ndahen 200 euro.A e keni pyt qytetarin ni test d-dimeri sa kushton?dhe gjithashtu rëntgeni për mushkri. Pothuaj 90 % e qytetarëve vje me ankesa Kovid. Ai nuk diagnostifikohet sepse nuk ka buxhet,sepse që në start pacientit i duhen 100 euro. Tash nuk ka pare. A e keni ditë që kjo sëmundje është pakufi.Duhet të bëni përpjekje,lërini projektet sepse është primare shëndeti i qytetarëve.

Gëzim Kryeziu - kur e kemi votu e kam mendu, sepse kemi 60 mijë banorë rezident dhe kushton 1 milion euro. Është dasht të mendohet ma herët.Unë jam kundër shfuqizimit,dhe jam për me vazhdu,të gjenden mjetet dhe tu bëhen pagesat.

Florije Bytyqi - po, vaksinat janë tuj u marrë,por ka pacient të shtruar që i kanë marrë dy dozat.Kemi edhe vdekje.

Jeton Rrakaqi - deri sa nëpër facebook po dalin si të arritura pagesat për Kovid edhe pse ka qenë e inicune prej një grup parlamentar tjetër dhe në anën tjetër e arsyetoni ndalimin e këtyre pagesave. Grupi parlamentar i PDK-së është kundër.

Shefket Kolgeci - përshëndet të pranishmit. Jemi në një gjendje që unë mendoj që është e jashtëzakonshme,dhe qeveria del mi ndal ndihmat për Kovid. Ne si gr. Parlamentar i LDK-së jemi kundër. Apeloj te Kryetari dhe te qeveria që të gjejnë mjete në çdo projekt, investim kapital,shërbime publike transfere,subvencione në mëyrën ligjore, që të pakten këtë vit ti ndihmojmë qytetarëve. Gjeneri mjete dhe ne do t'ju ndihmojmë.

Rilind Krasniqi - është shumë absurde që Kryetari në kohë pandemie ndajti mjete për klubin e futbollit dhe sot bje në rend dite që me i ndal pagesat për të infektuarit. Do duhej me ardh një pike se si me gjet fonde për barna shtesë për qytetarët e Komunës.

Xhemaj Kabashi - jemi në një situatë emergjente .Çështja e Kovid të jetë rend dite jo mu hek subvencionet por të ketë një lloj informimi prej ekzekutivit se sa janë duke u zbatu masat, nëse këto masa janë në rregull kjo kishte me ndiku edhe me zvogëlimin e rasteve. Kisha kërku angazhim ma të madhë te çdo individ por edhe te qeverija te respektimi i masave dhe parandalimi i nr. të infektuarve.

Florië Bytyqi - kisha kërkua me pas pas shtesë edhe për drejtorinë e shëndetësisë, me rrit numrin e testeve diagnostifikues, me pas material për rendëgen për mushkri, dhe të kemi një analizë laboratoriale d-dimeri.

Kryesuesi - e hedh në votim për me hek prej rendit të ditës.

18 për , 5 kundër
Tërhiqet kjo pikë

Pika 6. Pyetje dhe përgjigje;

Jeton Rrakaqi - para disa ditëve ka ndodh një aksident,ku një fëmijë ka rënë në xhama të thym.Pse s'po rregullohet pjesa para lokaleve?A ka përfunduar sheshi?

Kryetari - sheshi ka përfunduar,pritet pranimi teknik.

Rilind Krasniqi - a ka pas komision mbykqyrës?

Kryetari - po

Jeton Rrakaqi – le të na shpjegojë drejtori i shërbimeve publike se a ka qenë në paramasë ajo pjesë a jo?

Takimi përfundoi: **11:25**

Procesmbajtësja:
Dafina Haziraj